

HONORE DE BALZAK

1799. – 1850.

Jeta dhe krijimtaria

Honore de Balzak

- Balzaku hapi epokën e prozës realiste
- Deri kah fundi i shekullit XIX-XX romani ishte gjinia më pak e lëvruar
- Shkroi aq shumë romane që me të drejtë edhe quhet - Babai i romanit
- Një nga shkrimtarët e parë profesionistë – fitoi thjesht duke shkruar

Jeta

- Balzaku lindi në Tur të Francës më 20 maj 1799
- Studioi në kolegjin Tours e më pas u shpërngul në Paris bashkë me familjen
- Në vitin 1816 U regjistrua në fakultetin e drejtësisë dhe në të njëjtën kohë punonte në një zyre noterie, ku njohu figura avokatësh, gjuqtarësh që më vonë i shërbyen në romanet etij.



Balzaku me të ëmën

- Si bir i një borgjezeje e kishte vështirë të braktiste studimet, por vendosi dhe iu përkushtua letërsisë
- Ai shkroi me plot pasion dhe vdiq më 18 gusht 1850 pasi la mbrapa afro 100 vepra.



KOMEDIA NJERËZORE

- Komedia njerëzore – kryevepra letrare e Balzakit
- Përbëhet nga nëntëdhjetë romane dhe tregime të shkurtra
- Ofron një analizë të shoqërisë franceze në gjysmën e parë të shekullit XIX
- Në parathënien e veprës shpjegon qëllimet, veçantitë dhe strukturën e veprës.

Komedia njerëzore

Komedia njerëzore -Balzak

- Vepra e ndarë në tri pjesë:
 1. Studime për zakonet
 2. Studime filozofike
 3. Studime analitike
 - Komedia njerëzore" e Balzakut e përshkruan "këtë"-jetën në tokë, duke theksuar se komedia e vërtetë luhet në tokë.

Komedia hyjnore- Dante

- Vepra e ndarë në tri pjesë:
 1. Ferri
 2. Purgatori
 3. Parajsa
 - Komedia hyjnore" e Dantes përshkruan "atë", botën hyjnore;

Thënie nga Balzaku

- Prapa çdo pasurie të madhe, fshihet një krim i madh!
- Zemra e një nëne është një humnerë e thellë, në fundin e të cilës do të gjesh faljen!
- Femrat, kur nuk dashurojnë, kanë gjakftohtësinë e një avokati të vjetër
- Ndoshta virtyti nuk është asgjë më shumë, se sa mirësjellja e shpirtit.
- Vetmia është e mirë, por gjithsesi të duhet dikush, që të të thotë se vetmia është e mirë.
- Dashuria është poezia e shqisave.
- Lavdia është një helm që duhet marrë me doza të vogla.

Xha Gorioi

- "Xha Gorioi" është romani më i famshëm dhe më i lexuar i Balzakit
- Është shkruar në vitin 1834.
- Balzaku e shkroi kur ishte 35 vjeç, për 40 ditë gjatë të cilave, thonë se Balzaku nuk kishte bërë më shumë gjumë se 80 orë.
- Roman realist / roman shoqëror (përshkrim i shoqërisë pariziane nga fillimi i shekullit XIX)


Xha Gorioi

- Në roman Balzaku përshkroi shoqërinë bashkëkohore
- Karakteri është gjithmonë i varur nga ambienti nga vjen
- Romani fillon me një përshkrim të shtëpisë së pensionistëve (bujtinë) me erë të keqe
- Një bujtinë që përmban pothuajse të gjithë personazhet kryesore



Xha Gorioi

- Xha Gorio dhe rënia e tij në shoqëri (fati i protagonistit, një ish fabrikant i makaronave)
- Xha Gorio, i cili, për shkak të dashurisë së pakufishme atërore, kalon vitet e fundit të jetës së tij duke jetuar i varfur dhe i vetmuar në bujtinën e mjerueshme të zonjës Voker
- (ua dha gjithë pasurinë e tij vajzave që i adhuronte aq shumë)



Studenti- Rastinjaku

- Një simbol ambicie dhe dëshire për sukses
- Rastinjaku dhe ngritja e tij në shoqëri
- Studenti i drejtësisë Eugjen Rastinjaku - një fisnik nga jugu i Francës që vjen në Paris plot entuziazëm dhe ideale për sukses në shoqërinë arsitokrate
- Lidh tre klasa të ndryshme sociale: të varfurit, aristokratët dhe qytetarët



Vdekja e Gorioit

- Ai ndëshkohet me vetminë
- Vajzat e tij nuk e vizitojnë as në shtratin e vdekjes
- Ai vdes me iluzionin se ato janë të bukura, të mira, por të pakënaqura me jetën e tyre.
- Rastinjaku e ndihmon deri në fund plakun e braktisur

